

FJALA E DEPUTETIT OERD BYLYKBASHI

E HENE 14 SHTATOR 2023

E nderuar Kryetare,

Të nderuar kolegë,

Marrëveshje për pensionet, si kjo me Malin e Zi, paçim sa më shumë, sepse vlejnë gjithmonë, edhe sikur të mund të ndihmojmë një grup të vogël shtetasish shqiptarë, sidomos ata, që pensionin e kanë një gjë shumë të rëndësishme, në mënyrë individuale. Lidhur me faktin nëse vlen të votohet apo jo, pa diskutim, kjo marrëveshje duhet votuar, por unë dua të ndalem te diçka tjetër. Besoj se të gjithë ju gjatë fushatave elektorale, kur keni takuar qytetarët (unë besoj se të gjithë ju takoni qytetarët gjatë fushatave, sepse askush nuk zgjidhet deputet nga kolltuku), jeni ndeshur me pensionistët. Personalisht më ka ndodhur, besoj se edhe juve, që gjatë fushatës të takoj dikë, i cili u ankua se e kishte pensionin 150 mijë lekë të vjetër; ndërkohë dikush tjetër, që ishte ngjitur me të, më tha: “Unë e kam 75 mijë lekë të vjetër”. 75 mijë lekë të vjetër para 2 vjetësh! Ai merrte një pension sa gjysma e atij personit tjetër. Pensioni minimal për disa mijëra persona është 75 mijë lekë të vjetër. Ky është një turp! Bëjeni vetëm një llogari të thjeshtë: sa arrijnë këta qytetarë me këtë pension t’u rrijë me dinjitet termi “qytetarë”?! Bëni llogarinë sa detyrohet të shpenzojë ai pensionist për pjesën tjetër të ilaçeve, ato që nuk rimbursohen: 30, 40 mijë lekë të vjetër? Ai duhet të paguajë ujin dhe energjinë elektrike dhe nuk i mbetet asnjë lek. Sa janë këta persona? Janë disa mijëra, jo të gjithë pensionistët. Pensioni mesatar në fshat është nën 100 mijë lekë dhe, në mos gaboj, në qytet është diku te 150-170 mijë lekë. Sërish llogaria mbetet e njëjtë. Këta marrin diçka, që nuk ka lidhje me dinjitetin e tyre njerëzor, si individë, dhe, në fund fare, kjo Republikë angazhohet në Kushtetutë për dinjitetin e shtetasve të vet, dhe dinjiteti fillon së pari tek ata, te mënyra se si do të kenë mundësi të jetojnë. Ne e dimë shumë mirë që minimumi jetik sot është afro 200 mijë lekë të vjetër, ndërkohë një pensionist, me pension minimal, merr vetëm 75 mijë lekë të vjetër.

Ne kemi bërë një propozim, kemi depozituar në parlament një nismë ligjore për minimumin jetik prej 200 mijë lekësh, që nuk merret në shqyrtim. Ju refuzoni, si për të gjitha ligjet e tjera që vijnë nga opozita, duke i mbajtur pezull. Po flasim për minimumin jetik, jo për dinjitetin, sepse dinjiteti është më lart se kaq. Kur uleni në një restorant apo kur bëni diçka, a e vrisni mendjen ç’mund të bëni me 75 mijë lekë, po me minimumin 200 mijë?! Në fakt, për këtë më ngacmon diçka tjetër. Fakti që po prek tezën e dinjitetit, ishte ajo që na bëri të hapim sytë në Komisionin e Ligjeve para dy ditësh, kur Këshilli i Ministrave, me propozim të Gjykatës Kushtetuese, solli për miratim në Komisionin e Ligjeve, besoj edhe në komisionet e tjera, ligjin “Për disa ndryshime në ligjin për Gjykatën Kushtetuese”, vetëm për një arsye, që t’u rritet paga gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese. Arsyetimi kryesor është skandaloz për këdo që mendon se mund ta votojë pro: “Duhet një pagë dinjitoze”. Paga dinjitoze është 644 mijë lekë të rinj, pra 6 milionë e 440 mijë lekë, për gjyqtarin e Gjykatës Kushtetuese dhe për anëtarët e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, pra gjykata tjetër kushtetuese (se paguajmë dy gjykata kushtetuese ne, edhe atë të vetingut) dhe, për çështje dinjiteti, kryetari, edhe i njëres gjykatë, edhe i gjykatës tjetër kushtetuese, duhet ta ketë 20% më shumë, pra 773 mijë lekë të rinj, 7 milionë e 730 mijë lekë. Bëjini llogaritë, kryetari i Gjykatës Kushtetuese, por edhe kryetari i gjykatës alternative kushtetuese, asaj të vetingut, do ta kenë pagën sa 100 pensionistë bashkë, që kanë njëpension minimal në muaj. Kjo bëhet për arsye dinjiteti! Do të kemi pikën tjetër për të diskutuar nëse vlen apo nuk vlen kjo histori, por shtrohet pyetja: a vlen debati për dinjitetin, a është i rëndësishëm? Po i përgjigjem: po, pa diskutim, është i rëndësishëm.

Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të jenë po aq dinjitozë sa gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, të cilët kanë vetëm gjysmën e kësaj page, dhe, sërish, pensionisti, me pension minimal, i cili merr sa 1/100 e kryetarit, thotë: "Po dinjiteti im, ku është?". Çështja është: pse nuk bëjmë ne përpjekje që t'ua ngremë dinjitetin edhe pensionistëve, por ua ngremë dinjitetin gjyqtarëve të lartë, nëpunësve të tjerë të lartë shtetërorë apo edhe shërbëtorëve të tjerë publikë. Për ata që na shohin: nëse dikush do të kthehej pas në kohë në Athinën antike të shekullit V para Krishtit, kur debati i tyre ishte nëse duhej demokracia apo oligarkia (oligarkët janë pasanikët, në kuptimin e debatit që bëjmë ne sot, por jo atëherë; oligarkët ishin të paktë në numër dhe ishin më të mirët, ishin ata që mendonin se u takonte të qeverisnin, jo këta që nuk kanë shkollë, nuk kanë edukim dhe nuk dinë për çfarë votojnë), Athina atë kohë kishte zgjedhur që të dilnin qytetarët dhe t'i merrnin bashkë vendimet, madje i gjobisnin kur nuk dilnin. Ne nuk e bëjmë këtë. Nëse kthehet ndonjëri në kohë në këtë sallë, do të thotë: "Këta janë oligarkë", sepse ajo gjykatë propozon për veten e saj që t'i ngrihet rroga mujore në 7 milionë e 700 mijë apo 6 milionë e 400 mijë, sepse e di veten më të mirë. Pse nuk e bëjmë dot më të mirë për ata poshtë?! Pse nuk e bëjmë më të mirë për pensionistin, që merr 1/100-ën e pagës së kryetarit të gjykatës?! Pse nuk e bëjmë dot më të mirë për ata që marrin pagë minimale prej 400 mijë lekësh të vjetër, që i bie 1/20-a e kryetarit të gjykatës?! Ky nuk është diskutim populist, sepse është diskutim për ata njerëzit atje poshtë, që nuk e kuptojnë diskutimin tonë. Ne mendojmë se pavarësia e gjyqësorit arrihet nëpërmjet pagës. Jo, nuk arrihet nëpërmjet pagës, por arrihet nëpërmjet dinjitetit profesional. Sigurisht, pa diskutim, gjyqtarin e Gjykatës së Lartë dhe atë të Gjykatës Kushtetuese, për sa më takon mua, unë e paguaj njësoj me Presidentin, por kur u themi njerëzve që ju jeni 1/100-a e kryetarit, 1/90 e ca e anëtarit apo 1/20-a, është çështje problemi moral, nuk është më hierarki piramidale institucionale, por është hierarkia e normave morale që ka rënë. E keni këtu propozimin, në Parlament. Dje në Komisionin e Ligjeve na ka ardhur një projektligj i deputetit Leskaj, një vit e gjysmë pasi ishte depozituar.

Me këto llogari, kushedi kur mund t'i vijë koha propozimit që kemi bërë për minimumin jetik, që është për shqiptarët, për ata që kanë më shumë nevojë, por jo, kjo është shumë më e rëndësishme. Pra, propozimin që ka bërë Gjykata Kushtetuese për veten e vet e sjellin këtu, e sjell qeveria dhe mazhoranca do ta votojë, në fakt, duhen 84 vota për ta miratuar, do ta shohim nëse bëhen, por do ta votojë nën historinë e pavarësisë! Jo! Gjykata Kushtetuese i është vetofruar qeverisë. Ky është diskutimi. Edhe një herë, për diskutimin midis pavarësisë dhe dinjitetit të atyre njerëzve poshtë, dua të them se është qesharak argumenti zyrtar që transmetonin përfaqësuesit e qeverisë për gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese: "Duhet të kenë një pagë dinjitoze". E dini sa profesionistë juristë ka, që mund të jenë me të njëjtin nivel të anëtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të cilët e kanë shumë të vështirë vetëm ta imagjinojnë, jo më ta arrijnë pagën e gjyqtarit, edhe pse punojnë dhe përpiqen përditë. Nuk kanë gjyqe, gjyqet u shtyhen pa fund, sepse sistemi i drejtësisë është i bllokuar, por, për hir të reformës në drejtësi, ne duhet t'i bëjmë gjyqtarët "oligarkë të sistemit të drejtësisë"? "Jemi pak, dhe më të mirët" - ky është koncepti i oligarkisë. Kthehem edhe një herë në fillim, pa diskutim që marrëveshja vlen të votohet, pasi përfitojnë ata që preken, por kur të votojmë, duhet të kuptojmë edhe një herë se çfarë jemi duke bërë, si na shohin njerëzit atje poshtë, sepse është një histori ku vetëm dinjitet, ky shtet dhe kjo Republikë, nuk u garanton këtyre njerëzve, dhe ky është një turp!

Faleminderit!